




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3655/23 i datës 18.12.2023 dhe merret vendimi me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm.
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohej në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë kosto më të lartë se **220.00 € (dyqind e njëzet euro)** për një rast, ndërsa për shërbimet tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t'i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t'i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t'i përmbahen të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën së Rahovecit
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.174/23
Datë:27.12.2023

